
STATUTI
I
SHOQERISE TREGTARE "PARISOL" SH.P.K.

Sot, më datë 29.12.2021 (dymije e njezetenjë), ortaku i vetem themelues:

Z. Besar Llapashtica, shtetas shqiptar, i lindur ne Fier, me 27.03.1990 dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me numer. 032266246 dhe numer personal J00327070S, vendosi themelimin e Shoqerise "PARISOL" Shpk., me termat si me poshte:

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqeria Tregtare "PARISOL" Shpk., rregullon poziten e saj juridike, marredheniet e themeluesve, te organeve te saj, llojin e shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj, marrdheniet me te punesuarit, duke u bazuar ne ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar ne fuqi qe rregullojne marredheniet e Shoqerive Tregtare, (ne vijim Shoqeria).

NENI 1.

Objekti i veprimtarise

Shoqeria ka per objekt veprimtarie:

"Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike solare (fotovoltaike) dhe energjise se eres (eolike) ne Republiken e Shqiperise dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministrive e Institucioneve te Shtetit Shqiptar i te gjitha miratimeve, lejeve dhe licensave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise. Shoqeria ka te drejte te ushtroje çdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes".

NENI 2

Emri dhe selia e Shoqerise

Shoqeria eshte Person Juridik Privat. Shoqeria do te paraqitet ne qarkullimin juridik-civil me emertimin e saj "PARISOL" Shpk.

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: Njesia Administrative Topojë, Fshati Grykë, Pasuria 558, Zona Kadastrale 3358, Fier.

NENI 3

Kohezgjatja e Shoqerise.

Afati kohor i zhvillimit te aktivitetit te shoqerise eshte i perhershem.

NENI 4.

Regjimi juridik i Shoqerise

Shoqeria udhehiqet nga parimet e ekonomise se tregut. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo do te organizohet si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit se Themelimit, Statutit si dhe dispozitave te legjislacionit tregtar e atij civil ne fuqi.

Me vendim të Asamblese së Përgjithëshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plote me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj. Statuti mund të ndryshojë duke ndjekur normat e mësipërme. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vullnet të saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE.

NENI 5.

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhen në kapitalin fillestar.

Pasurite e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasurite) mund të tjetërsohen, të jepën me qera, të lihen peng e hipoteke me miratimin e Ortakëve.

NENI 6

Te drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.

Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të eksperteve kontabel të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do t'u përhapë personave të paautorizuar do të shkaktojë dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruar deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 7.

Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët, e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtojnë pasurite e shoqërisë tregtare si të ishin pasurite e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë diçkë për gjendjen e paafetësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varesi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsiper ndaj paleve të treta.

NENI 8.

Ndalimi i konkurrencës

Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

Ndalimi i përmendur më sipër mund të ndryshohet apo shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga asamblëja e përgjithshme me 51% të votave.

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së çështjes apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj çështjeje.

Nesë ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e demit.

Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e demit, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:

1. të pranojë që transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
2. t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
3. t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kredite, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

NENI 9.

Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës

Ortakë mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dem të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkak të tjerë, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortakë që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkakët e largimit. Administratoret duhet të therrasin mbledhjen e asamblëse të përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dënimin për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakët do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshme.

Ortakë ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asamblëja e përgjithshme nuk mbledhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkakët e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortakë që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet të demshpërblejë shoqërinë për demet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkakëve të paarsyeshme.

Ortakë që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e demit të pesuar.

NENI 10.

Përjashtimi i ortakut

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asamblëja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara në Statut apo nëse ekzistojnë shkakë të arsyeshme për përjashtimin e tij sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkakë të tjerë të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkakë të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në të, rastet kur ortakë:

- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkaktonte dëm shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;

- perfshihet ne veprime, te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e marredhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut
- me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise.
- Gjate procedures se perjashtimit te ortakut, me kerkese te paditesit, gjykata mund te marre nje mase per sigurimin e padise, duke pezulluar te drejten e votes se ortakut, qe kerkohet te perjashtohet, si dhe te drejttat e tjera, qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, kur ajo e vlereson kete mase si te nevojshme dhe te justifikuar.
- Shoqeria ka te drejte t'i kerkoje ortakut te perjashtuar shperblimin e demit te pesuar nga veprimet, qe kane sjelle perjashtimin.
- Ortaku ka te drejte t'i kerkoje shoqerise shperblimin e demit te pesuar, nese kerkesa per perjashtim nuk eshte e bazuar.
- Ortaku nuk ka te drejte t'i kerkoje shoqerise likuidimin e kuotes, nese ai perjashtohet per shkaqe te arsyeshme, por, nese shoqeria ngre ndaj tij padi per shperblim demi, ortakut ka te drejte te kompensoje çdo shume, qe do te kishte te drejte ta perfitonte ne cilesine e likuidimit te kuotes, me demin e kerkuar nga shoqeria.

III. KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE.

NENI 11.

Aktiviteti i Shoqerise bazohet ne kerkesat e ekonomise e te tregut. Veprimtaria ekonomike ndertohet mbi parimet e llogarise dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

NENI 12.

Kapitali fillestar i investuar nga Ortaket, perben bazen e krijimit te fondit themeltar te mjeteve te xhiros. Administratori i dorezon Ortakeve dokumentin vertetues per sasite e shumave te derdhura ne fazen e themelimit.

Vleresimi i kapitalit ne natyre eshte bere nga Ortaket Themelues ne momentin e themelimit te Shoqerise.

Ortaket mund te kryejne ne baze te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, financime per llogari te shoqerise ne perpjesetim me kuotat e zoteruara ne kapital, mbulimin e humbjeve ashtu edhe per financime jo fitimpruese.

NENI 13.

Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi ne para i ortakut te vetem themelues. Ai perbehet nga 1 (nje) kuote. Kontributi ne para per 1 (nje) kuote do te kete vleren prej 1,000 (nje mije) Leke.

Ortaku themelues do te zoteroje kuotat ne Shoqerine "PARISOL" Shpk., si me poshte:

- Z. Besar Llapashtica ne cilesine e Ortakut Themelues zoteron 1 (nje) kuote me vlere sa 100% te vleres se kapitalit themeltar te shoqerise me vlere te pergjithshme prej 1000 Leke.

Kapitali themeltar eshte derdhur ne total nga ortakut themelues ne ditën e sotme. Vleresimi dhe pagesa e kapitalit themeltar eshte kryer nga ortakut me miratimin e ketij Akti.



NENI 14.**Pronesia mbi kuotat**

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nepermjet:

- kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- shit-blerjes;
- trashegimise;
- dhurimit;
- ne çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

NENI 15.**Miratimi i Asamblese se Pergjithshme per fitimin apo kalimin e kuotave.**

Pavaresisht nga menyra e fitimit apo kalimit te kuotave, eshte i nevojshem miratimi i Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Ne çdo rast, ortakët e shoqerise gezojne te drejten e parablerjes. Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen sipas ligjit, ndryshe jane te pavlefshme.

NENI 16.

Kuotat mund te anulohen ne çdo rast me miratimin e ortakut perkates dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i rrjedhin ortakut nga zoterimi i kuotes, shuhen me anulimin e tyre.

Rastet e anulimit te kuotes do te percaktohen nga rregullore te posaçme, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve me 51% te votave.

Ndersa likuidimi i saj do te behet sipas percaktimeve te nenit 9 te ketij statuti.

NENI 17.**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet nga Asambleja e Pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave.

Zmadhimi i kapitalit mund te vendoset kur e kerkojne interesat e Shoqerise duke vendosur kuotat suplementare te Ortakeve.

Asambleja e Pergjithshme, vendos per zvogelimin e kapitalit te Shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit nuk duhet te demtojte kreditorët e as te krijojte pasiguri tek ata qe kane dhene kredi para publikimit te zvogelimit te kapitalit. Ne te kunderten Gjykata e konsideron te pavlefshem kete vendim mbi kerkesen e kreditorëve.

NENI 18.**Fondet rezerve**

Shoqeria disponon lirisht mjetet e veta financiare per shlyerien e detyrimeve gjate veprimtarise se saj.

NENI 19.**Perdorimi i te ardhurave neto**

E ardhura neto qe rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bera per kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vleres se amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat qe rritin kredine per investime, pagat e shperblimet, perdoret nga Ortaket, sipas qellimeve te tyre.



NENI 20.**Bilanci, plani financiar.**

Pasuria e Shoqerise vleresohet ne bilancet e saj ne monedhe te vendit ose ne monedhe te huaj sipas vleresimit te Ortakeve ose eksperteve ne momentin e Themelimit te Shoqerise.

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes. Forma e bilancit percaktohet nga Administratori ne harmoni me format e bilanceve te vendosura ne Republiken e Shqiperise.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik te Shoqerise, te shprehur ne leke ose valute te konvertueshme. Llogaria ekonomike do te mbahet ne Shqiperi. Shkembimi i monedhes shqiptare me ate te huaj dhe anasjelltas behet sipas kursit zyrtar ose privat te kembimit.

NENI 21.**Shperndarja e fitimeve**

Ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise. Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

NENI 22.**Kufizimi i shperndarjeve te fitimeve**

Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit:

- a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
- b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.

Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e mesiperme.

Kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

Administratoret, te cilet nga pakujdesia leshojne nje certifikate te pasakte te aftesise paguese, pergjigjen personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividendeve te shperndare.

Ortaket, qe kane marre nga shoqeria dividende, pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividendeve, qe u jane shperndare kur nuk eshte leshuar certifikata e aftesise paguese, ose kur, pavaresisht leshimit te certifikates, keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e paaftesise paguese te shoqerise, ose ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishin pasur dijeni per kete gjendje.

IV. ORGANET E SHOQERISE.**NENI 23.****Asambleja e Pergjithshme**

Organi themelor i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime te cilat kerkojne $\frac{3}{4}$ e votave ne rastet e meposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
4. shperndarjen e fitimeve;
5. raste te tjera te parashikuara nga ligji ose statuti;



Per rastet e tjera ajo vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres si me poshte:

1. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
1. çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
2. percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
3. emerimin e shkarkimin e administratoreve;
4. emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
5. percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar.
6. mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire
 - a. pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se
 - b. veprimtarise;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
8. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
9. perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

NENI 24.

Asambleja e Pergjithshme eshte e detyruar dhe me çdo kusht te mblidhet sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise ne rastet e meposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise.
- Ne rastet e parashikuara ne piken nje dhe tre me siper, perpara Asamblese se Pergjithshme paraqitet nje raport i pergatitur nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.
- Ne raste e parashikuara ne piken nje dhe tre Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

NENI 25.

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vonë se 15 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.



NENI 26.

Kuorumi i nevojshem dhe vendim-marrja

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 51% per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me siper, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarrres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Per ceshtjet e tjera, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrres.

Çdo kuote jep te drejten e nje vote. Ortaket, qe nuk jane te pranishem, mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejttat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave.

NENI 27.

Procesverbali i mbledhjes se asamblese

Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratori pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.

Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarrresve, si edhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.

NENI 28.

Hetimet e posaçme

Asambleja e pergjithshme mund te vendose nisjen e nje hetimi te posaçem per parregullsite pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare. Hetimi kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes.

Ortaket qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise, apo nje vlere me te vogel te parashikuar ne statut dhe/ose cilido kreditor i shoqerise mund t'i kerkojne asamblese se pergjithshme emerimin e nje eksperti te pavarur te fushes, kur ka dyshime te bazuara per shkelje te ligjit ose te statutit ne te kundert brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per emerimin e ekspertit te pavarur, mund t'i kerkojne gjykates emerimin e ketij eksperti. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim brenda 60 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses, kerkesa e ortakeve vleresohet e refuzuar.

E drejta per te kerkuar hetim te posaçem, duhet te ushtrohet brenda 3 vjeteve nga data e regjistrimit te shoqerise tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsite e procesit te themelimit, si dhe brenda 3 vjeteve nga data e veprimit, qe konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsite e ushtrimit te veprimtarise tregtare.

Ne rastet e vendimeve te parregullta te administratorit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme ka te drejte ti kerkoje Gjykates kompetente shfuqizimin e ketyre vendimeve, kur keto perbejne shkelje te rende te ligjit apo statutit.



Ortakët e cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme apo secili kreditor i shoqerise mund ti kerkoje asamblese se Pergjithshme shfuqizimin si me siper, ose ata mund te proçedojne vete perpara gjykates brenda 30 diteve nga refuzimi i asamblese per ngritjen e padise. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk merr nje vendim brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e ortakeve apo kreditoreve vleresohet e refuzuar.

Proçedurat perpara gjykates ndiqen nga nje perfqesues i posaçem i shoqerise i emeruar nga Asambleja e Pergjithshme. Kreditoret apo ortakët e siperpermendur kane te drejte te kerkojne perpara gjykates zevendesimin e perfaqesuesit kur ka dyshime ne lidhje me te per perfaqesimin e tij jo ne interes te shoqerise.

Rastet e hetimeve te posaçme dhe shfuqizimit te vendimeve te parregullta do te rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

V. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 29.

Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, nuk mund te jete me i gjate se 5 vjet, me te drejte ripërteritjeje.

Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Statuti mund te caktojte rregulla te posaçme per emerimin e administratoreve.

Administrator i Shoqerise emërohet:

- Z. Besar Llapashtica, shtetas shqiptar, i lindur ne Fier, me 27.03.1990 dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me numer. 032266246 dhe numer personal J00327070S

Shoqeria do te perfaqesohet perpara ç'do organi administrativ, gjyqesor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe ne marredhenie me te tretet nga Administratoret e shoqerise, te cilet ushtrojne te drejtat e tyre ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 30.

Te drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratoret kane te drejte e detyrime te:

1. kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
2. perfaqesojte shoqerine tregtare;
3. kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
4. pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, te paraqese keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
5. krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
6. kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
7. raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
8. kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

-
9. te therrase asamblene e pergjithshme kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 31.
Shperblimi i administratoreve

Shperblimit baze te administratoreve mund t'i behen shtesa, qe mund te jene perqindje ne fitim ose te ngjashme. Shperblimet e administratoreve percaktohen me vendim te zakonshem te asamblese se pergjithshme.

Shperblimi, duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e pergjithshme mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratoreve ne masen e pershtatshme.

Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqerise tregtare publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 32
Ekspertet Kontabel

Shoqeria emeron ekspertin kontabel per nje afat nje vjecar ne rastet e parashikuara nga ligji. Emerimi i tyre behet nga Asambleja e Pergjithshme.

Ekspertet kontabel jane pergjegjes per mirembajten e dokumentave te shoqerise.

Ata jane pergjegjese per demet e shkaktuara qe mund te vijne nga mbajtja e llogarive ne menyre te parregullit.

Nuk mund te emerohen si eksperte, themelues, administratore, persona qe kane lidhje gjaku deri ne shkallen e katert.

VI. MARRDHENIET E PUNES.

NENI 33.

Marrdheniet e punes ne Shoqeri rregullohen sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar te Punes.

Punesimi ne Shoqeri realizohet me ane te kontrates individuale te punes midis Shoqerise e te punesuarve. Marrdheniet midis Shoqerise e sindikates rregullohen nepermjet kontrates kolektive te punes.

NENI 34.

Te punesuarit dhe punonjesit drejtues administrativ jane pergjegjes per demet qe i shkaktojne Shoqerise per faj te tyre dhe pergjigjen para saj civilisht.

VI. PRISHJA E SHOQERISE. LIKUJDIMI.

NENI 35.

Shoqeria priset ne rast kur:

1. kur mbaron kohezgjatja e themelimit te saj;
2. me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
3. ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunktionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;
4. ne raste te tjera, te parashikuara ne statut;
5. ne raste te tjera, te parashikuara me ligj;
6. per cdo shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve, etj.;

Prishja e shoqerise regjistrohet ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit nga Administratoret.

NENI 36.

Likuidimi i shoqerise

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga asambleja e pergjithshme. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Çdo person i interesuar, ka te drejte t'i kerkoje gjykates zevendesimin e likuiduesit, sipas vendimit te ortakeve, nese paraqet arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likuiduesit e emeruar si me siper. Kerkesa duhet te depozitohet ne gjykate brenda 30 diteve nga data e caktimit te likuiduesit.

Gjykata emerion likuiduesin, ne rastet kur shoqeria tregtare priset me vendim gjykate.

Likuiduesit shkarkohen dhe zevendesohen me te njejtat kushte, te parashikuara ne dispozitat per emerimin e tyre.

Administratoret e shoqerise i njoftojne per regjistrim, Qendres Kombetare te Regjistrimit te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre, per te perfaqesuar shoqerine, se bashku me dokumentet perkatese. Likuiduesit depozitojne nenshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojne, gjithashtu, Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim cdo ndryshim per identitetin dhe tagrat e tyre te perfaqesimit. Emerimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Me hapjen e procedurave te likuidimit, emri i regjistruar i shoqerise ndiqet nga shenimi "ne likuidim". Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj brenda 30 diteve. Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

NENI 37.

Te drejtat e detyrimet e likuiduesve

Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, likuiduesit verejne se pasuria e

shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

NENI 38.

Bilancet

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet miratohen nga Asambleja e Pergjithshme.

NENI 39.

Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditoreve, likuiduesi u shperndan ortakeve aktivet e mbetura, sipas te drejtave qe ata kane ne ndarjen e fitimeve, me perjashtim te rastit kur statuti parashikon radhe preference. Pasurite, qe i jane dhene shoqerise me qira apo ne perdorim, me cfaredo titulli u kthehen ortakeve. Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

NENI 40.

Likuidimi i thjeshtezuar

Shoqeria mund te likuidohet nepermjet nje procedure te pershpejtuar, nese kjo vendoset nga te gjitha ortaket dhe kur keta deklarojne perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditoreve jane shlyer e jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemarresit. Administratoret, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", njoftojne per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit vendimin per likuidimin e shoqerise, nepermjet procedures se thjeshtezuar.

Administratoret jane pergjegjes per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar. Pervec administratoreve, ortaket apo aksionaret e shoqerise pergjigjen ne menyre solidare deri ne shumat e marra.

VII. DISPOZITA TE FUNDIT.

NENI 41.

Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit .

NENI 42.

Gjithçka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 43.

Ky Statut perpilohet ne 3 kopje te njejta ne gjuhen shqipe, me nga 12 (1-12) flete secila kopje dhe pasi lexohen, nenshkruhen pa verejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES:

Z. Besar Llapashtica

Besar Llapashtica

